

# **STATUT**

## **ISHOOËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

### **“ Grand Construction” SHPK**

#### ***NENI 1***

#### **EMËRTIMI I SHOOËRISË**

Sot me datën 13.09.2021, une ortaku themelues kam krijuar një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar me Emrin: **“ Grand Construction” SHPK**

Themeluesi i Shoqërisë është:

**Z.Roland Hysa**, i shtetësisë shqiptare, i datelindjes 14.02.1987, lindur ne Tirane, banues ne Tirane, identifikuar me numer personal 170214085D dhe Nr. Karte ID 037143234.

#### ***NENI 2***

#### **SELIA E SHOOËRISË**

Shoqëria "**Grand Construction**" SHPK do ta kete seline saj ne Tirane me adresen **Yzberish, Zona Kadastrale Nr.3866, Nr. Pasurie 306/396-N11,Tirane**,dhe do te ushtroje aktivitetin e saj ne gjithe territorin e e Republikes se Shqiperise.

Ajo mund te krijojë ose të mbyllë në Shqiperi ose jashte saj, filiale, përfaqësi apo seli të tjera.

#### ***NENI 3***

#### **OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOOËRISË**

Objekti i veprimtarise ekonomike te shoqerise do te jete:

Kryerja e punimeve te gipsit,patinime,lyerje,instalime hidraulike, elektrike, punime termoizoluese,shtrim pllakash, shtresa te varfera dhe zera te tjere ne kete fushe te ndertimit.Ndertim dhe mirembajtje e objekteve te ndryshme.Punime karpenieri,murature,suvatim,germime,prishje objektesh per ndertim. Import Export I materialeve te ndryshme te ndertimit dhe mallrave industrial te te gjithe llojeve. Punime stampim fotografish, shtypshkrime te ndryshme, postera, reklama, stampime ne bluza, etj.



tregtim materiale elektronike(kompjuter, fotokopje, printera, etj), prodhim dhe montim duralumini, tregtim materialesh elektrike, punime druri dhe melamine dhe konstruksione metalike, sinjalistike rrugore, tregtim i artikujve te ndryshem ushqimor. Shoqeria mund te bleje, shese, te marre dhe te jape me qira pasuri te luajtshme dhe te paluajtshme; Te nenshkruaje marreveshje; Te marre hua, hipoteka dhe cdo gje tjeter qe konsiderohet te jete e nevojshme nga asambleja e pergjithshme. Tregtim material higjeno-sanitare. Tregtim dizinfektantesh. Tregtim inute bujqesore. Tregtim material kancelarike. Tregtim bime dekorative. Tregtim materiale te ndryshme industriale me perdorim te gjere. Tregtim me shumice tonera, fikese zjarri dhe kolaudim fikese zjarri. Mirembajtje, riparim te pajisjeve te teknologjise se informacionit, telekomunikacionit, radio nderlidhje, teknologjise se interkonjeksionit, paisje per ruajtje fizike, fotokopje, printera dhe servise te pajisjeve te mesiperme. Sherbime dhe tregtime te materialeve audiovizive, video telekonferenc. Ne fushen e tregtimit me pakice dhe shumice, importi dhe eksporti te : veshmbathje, konfeksione, kostume sportive, hidrosanitare, hidraulike, elektrike, detergjente, artikuj tualeti dhe kozmetike, kancelari per zyra dhe shkolla, orendi shtepiake, mobilje, pajisje elektrike, elektronike elektroshtepiake, fruta perime, artikuj industrial ushqimor dhe blegtoral, bime medicinale e etero vajore, pije te ndryshme alkoolike e freskuese, automjete te te gjitha llojeve, transport per vete dhe per te tjeret. Prodhim dhe tregtim te materialeve duralumini, plastike dhe druri, dyer e dritare shkollore etj, pjese kembimi per makina e automjete, goma e bateri, pike servisi Rikonstruksione. Ndertime ujsjellesi, kanalizime, impinte vaditje, kanale, puse etj. Sistemet disifektimi te lokaleve Ambjente te mbyllur dhe te hapur.

Punime restaurimi, restaurimi i monumenteve te kultures dhe veprave te vecanta arkeologjike. Punime sherbimi, punime ne siperfaqe te gjelberta parqe pyll; pastrim i siperfaqeve urbane, mirembajtje dhe zhillim i siperfaqeve urbane dhe dekorit – ndricime e sinjalizime Sherbime pastrimi te ndryshme te ambjenteve te brendshme dhe te jashteme. Tregtim i te gjitha llojeve te mallrave, materialeve, automjeteve te te gjitha llojeve me zinxhire dhe goma. Tregtim i paisjeve dhe impianteve te ndryshme te karakterit publik, industrial , kulturor, sportiv dhe bujqesor. Importim dhe eksportim te tyre. Tregtim vegla pune, vajra lubrifikante, paisje elektronike , kompjuter dhe aksesore. Tregtim te paisjeve dhe sistemeve te impianteve te ftohjes dhe ngrohjes, kondicionere, si dhe impiante te tjera te ndryshme te cdo lloji. Projektim instalim i paisjeve elektrike, industriale, elektro – shtepiake, sistemeve te ngrohje ftohjes, kondicionere etj.

Tregtim te paisjeve elektrike dhe elektronike te prodhimit, transmetimit, shperndarjes, kontrollit dhe matjes se energjise elektrike: transformatore, gjenerator, elektromotorr, matesa inteligjente, impiante te prodhimit dhe furnizimit me energji, sisteme automatike industriale dhe te ndricimit. Tregtim pjese kembimi, goma te llojeve te ndryshme, bateri etj Tregtim i karburanteve.

#### **NENI 4**

#### **KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË**

Kapitali themeltar i shoqërisë 100.000 (njqind mije) lekë kapital i ndarë në 1 kuote. Kapitali I shoqerise nenshkruhet menjehere dhe do te paguhet nga ortakut qe zoteron 100% te kontributeve ne kapitalin e shoqerise:



**Z.Roland Hysa**, i shtetesise shqiptare, i datelindjes 14.02.1987, lindur ne Tirane, banues ne Tirane, identifikuar me numer personal I70214085D dhe Nr. Karte ID 037143234.

**NENI 5**  
**TRANSFERIMI I PJESËVE TË KAPITALIT THEMELTAR**

Pjesët e kapitalit janë lirisht të transferueshme në rrugë të trashëgueshme. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore midis bashkëshortëve, si edhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve. Personi që fiton të drejta mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku do të ketë të drejtat që gëzonte zotëruesi i kuotës, duke përjashtuar të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, deri në momentin e regjistrimit ne QKR. Për transferimin e kuotave të kapitalit themeltar midis ortakëve do të respektohet e drejta e parablerjes midis ortakëve, dhe në rast të transferimit të kuotave tek të tretët duhet të kërkohet miratimi i shoqërisë.

**NENI 6**  
**KALIMI ME KONTRATË I KUOTAVE**

Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim dhe sipas formaliteteve të përcaktuara nga Administratori. Kjo kontratë do të dërgohet në selinë e shoqërisë. Administratori mund të refuzojë regjistrimin e kalimit të kuotës në QKR në rast se kjo kuotë nuk është shlyer plotësisht ose në rast se Administratori nuk është dakord me personin të cilit i kalon kuota. Nëse Administratori refuzon të regjistrojnë kalimin e kuotës, ai do të njoftojë për mospranimin personin të cilit i kalohen kuota, brenda një muaji nga data në të cilën është paraqitur në shoqëri kërkesa për regjistrimin e kalimit të kuotës.

**NENI 7**  
**KOHËZGJATJA E SHOQËRISË**

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohe të papërcaktuar.

**NENI 8**  
**ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

Administratori i shoqërisë do te jete **Z. Z.Roland Hysa**, i datelindjes 14.02.1987, lindur ne Tirane, banues ne Tirane, identifikuar me numer personal I70214085D dhe Nr. Karte ID 037143234 me të drejtë ripërtëritje.

- Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakëve, që përfaqësojnë më tepër se gjysmën e pjesëve të kapitalit themeltar.



- Administratori ka të gjithë kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretë në emër të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep ortakëve. Administratori mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë.
- Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose të tretëve për shkelje të ligjeve, statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
- Administratorit i paguhen të gjitha shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe shpenzime të tjera në lidhje me pjesëmarrjen e tyre në mbledhje lidhur me përmbushjen e detyrave të tyre, me fonde të marre nga llogaria e shoqërisë.

#### **NENI 9**

#### **MARRËVESHJET E NDALUARA**

- Administratorit ose ortakëve që nuk janë persona juridikë nuk u lejohe të kontraktojnë në çfarëdo lloj forme, të marrin hua të shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj për paradhënie si dhe të bëhen dorëzanës apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve.
- Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.
- Kjo masë ndaluese zbatohet gjithashtu ndaj bashkëshortëve paraardhësve dhe pasardhësve të personave të cituar në paragrafin e parë të këtij neni, si dhe ndaj çdo personi ndërmjetës.

#### **NENI 10**

#### **ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE**

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të ligjit, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Asambleja e Përgjithshme mund të parashikojë përfitime, nëpërmjet shpërblimeve në para, pensione, sigurime ose forma të tjera, për çdo person i cili ka qenë por nuk është më në detyrë apo i punësuar në shoqëri, shoqëri të tjera të cilat janë ose kanë qenë shoqëri të kontrolluara ose për shoqëri paraardhëse të shoqërisë ekzistuese ose të filialeve të saj, ose për çdo familjar të tyre (përfshirë bashkëshortin/en, ish-bashkëshortin/en) ose persona të cilët janë ose ishin në varësi të tyre, dhe mund të paguajë kontribute në fonde të caktuara për dhënien e përfitimeve të tilla.

Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- ndryshimet e statutit;
- emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;

- përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;
- mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- përcaktimin e kushteve dhe rregullave për punësimin e personave të jashtëm sipas nevojave të Shoqërisë.
- çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

#### ***NENI 11***

#### **ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT**

- Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të kualifikuar, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimit të ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e kualifikuar të votave të ortakëve.
- Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar të votave.

#### ***NENI 12***

#### **TË DREJTAT E SHOQËRISË DHE ORTAKËVE**

- Shoqëria ka të drejtë të lidhë kontrata dhe të nënshkruajë marrëveshje brenda dhe jashtë vendit.
- Shoqëria përgjigjet ndaj të tretëve vetëm dhe ekskluzivisht me kapitalin e derdhur, duke u përjashtuar përgjegjësia personale e çdo ortaku.
- Ortakët përballojnë humbjet deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.
- Ortaku ka të drejtë të marrë në çdo moment raportin e administrimit inventarët, llogaritë vjetore, për tre vitet e fundit financiare, duke qenë i ndihmuar po të jetë nevoja nga një ekspert i zgjedhur prej tij, i cili i nënshtrohet detyrimit për ruajtjen e sekretit profesional.
- Një ose disa ortakë që përfaqësojnë të paktën 1/10 e kuotave të kapitalit mund të kërkojnë në rrugë gjyqësore caktimin e një eksperti për paraqitjen e një raporti për një ose disa vendime administrative.
- Ortakët mund të caktojnë një përfaqësues ligjor për administrimin e çështjeve të veçanta ligjore, siç është p.sh përfaqësimi në gjykatë etj. Honorarët vendosen në marrëveshje midis ortakëve dhe përfaqësuesit ligjor.

#### ***NENI 13***

#### **DETYRAT E ORTAKËVE**

Ortakët detyrohen të depozitojnë kontributin e tyre në kapitalin themeltar.

Çdo ortak detyrohet të sigurojë në kohë dhe plotësisht detyrimet e tij ndaj shoqërisë dhe ortakëve të tjerë.

Kur ortaku nuk i përgjigjet detyrimeve, atëherë ortaku tjetër, pasi e ka njoftuar dhe ai nuk ka plotësuar detyrimin kërkon dëmshpërblimin.

#### **NENI 14** **VOTAT E ORTAKËVE**

- Në përputhje me të drejtat ose kufizimet që rrjedhin nga kuotat, çdo kuotë i jep ortakut (në rastin kur është individ) të pranishëm apo përfaqësuesit të tij të autorizuar ose ortakut (në rastin kur është person juridik) i cili është i pranishëm përmes përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt, të drejtën e një vote.
- Asnjë ortak nuk do të votojë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve, në lidhje me kuotën e zotëruar prej tij, nëse nuk ka shlyer tërësisht detyrimet që kanë të bëjnë me këtë kuotë.
- Të gjitha votat e pa kundërshtuara në një mbledhje ose mbledhje të shtyrë do të jenë të vlefshme.

#### **NENI 15** **VOTIMI ME PROKURË**

Përfaqësuesi do të emërohet nga ortaku sipas formës së mëposhtme (ose në formën e zakonshme apo formën që mund të miratohet nga Administratori):

Unë/Ne i/të nënshkruari/t, ....., në cilësinë e ortakut/ortakëve të shoqërisë së lartpërmendur, emëroj/më ....., ose në pamundësi të tij, ....., në cilësinë e përfaqësuesit/ve tim/tonë për të votuar në emër/emrat tim/tonë dhe në llogarinë time/tonë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë e cila do të mbahet më ..... 15....., dhe në çdo mbledhje të shtyrë.

Nënshkruar më..... 15.....”.

- Në rastet kur dëshirohet tu jepet ortakëve mundësia për të udhëzuar përfaqësuesin për mënyrën veprimit, caktimi i përfaqësuesit bëhet sipas formës së mëposhtme (ose në formën e zakonshme apo formën që mund të miratohet nga Administratori):

Unë/Ne i/të nënshkruari/t, ....., në cilësinë e ortakut/ortakëve të shoqërisë së lartpërmendur, emëroj/më ....., ose në pamundësi të tij, ....., në cilësinë e përfaqësuesit/ve tim/tonë për të votuar në emër/emrat tim/tonë dhe në llogarinë time/tonë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë e cila do të mbahet më ..... 15....., dhe në çdo mbledhje të shtyrë.

Kjo formë do të përdoret për vendimet e përmendura më poshtë:



Vendimi Nr. 1 \*pro \*kundër.

Vendimi Nr. 2 \*pro \*kundër.

Përveç udhëzimeve të tjera, përfaqësuesi mund të votojë ose abstenojë, siç e quan të arsyeshme. Nënshkruar më..... 15.....”.

- Caktimi me shkrim i përfaqësuesit ose një kopje e noterizuar apo e miratuar nga Administratori depozitohet në selinë e shoqërisë ose në një vend tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, siç përcaktohet në njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme ose në ftesën për të caktuar një përfaqësues të dërguar nga shoqëria në lidhje me mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme. Akti i emërimit të përfaqësuesit duhet të depozitohet jo më vonë se 48 orë përpara orës së mbledhjes ose mbledhjes së shtyrë, në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.
- Në rast se akti i emërimit të përfaqësuesit jepet nëpërmjet komunikimit elektronik të dërguar në adresën elektronike (*email*), ky akt duhet të merret jo më vonë se 48 orë përpara orës së mbledhjes ose mbledhjes së shtyrë në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.

#### **NENI 16**

#### **EKSPERTI KONTABËL I AUTORIZUAR**

##### **Emërimi dhe shkarkimi**

Shoqëria “**Grand Construction**” SHPK mund të emërojë një ekspert kontabël të autorizuar. Emërimi i ekspertit kontabël të autorizuar bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve.

Shqyrtimet e bëra pa caktuar ekspert kontabël të autorizuar në rastet e detyruara me ligj si edhe raportet e ekspertëve kontabël të autorizuar, të emëruar në kundërshtim me rregullat e parashikuara në ligj janë të pavlefshme.

Ekspertët kontabël të autorizuar emërohen nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve për një periudhë të caktuar financiare, në rast gabimi ose pengimi, eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet nga funksionet e tij me vendim gjykatë.

##### **Detyrat e ekspertit kontabël të autorizuar**

Garanton që llogaritë vjetore janë të rregullta dhe të hartuara me sinqeritet konform ligjeve dhe jep një pasqyrim besnik të rezultatit të operacioneve të vitit të kaluar financiar si dhe të gjendjes financiare të trashëgimisë së shoqërisë në fund të këtij viti financiar.

Verifikon librat e llogarive dhe fondet e shoqërisë dhe kontrollon përshtatjen e kontabilitetit të saj me legjislacionin në fuqi.

Verifikon përputhjen me llogaritë vjetore të informacioneve të dhëna në raportin e administrimit nga administratori përpara asamblesë së ortakëve si dhe në dokumentet që i janë dërguar asamblesë mbi gjendjen financiare dhe llogaritë vjetore.

Eksperti kontabël i autorizuar është i detyruar t'i bëjë të njohur administratorit dhe asamblesë së ortakëve.

- Kontrollat dhe verifikimet që ka kryer dhe sondazhet që ka bërë.

- Pjesët e bilancit dhe të dokumenteve të tjera të kontabilitetit në të cilat sipas tyre duhet të ishin bërë ndryshime duke bërë gjithashtu edhe të gjitha vërejtjet e duhura mbi metodat e vlerësimit të përdorur në përpilimin e këtyre dokumenteve.
- Parregullsitë dhe pasaktësitë që ka zbuluar.
- Përfundimet që rrjedhin nga vërejtjet dhe korrigjimet e mësipërme mbi rezultatet e vitit financiar, të krahasuara me ato të vitit financiar të mëparshëm.

Eksperti kontabël i autorizuar thirret nga asambleja e përgjithshme e ortakëve, kur shqyrtohet mbyllja e llogarive të vitit të kaluar financiar dhe sa herë kërkohet nga asambleja e ortakëve.

**Përgjegjësitë ligjore të ekspertit kontabël.**

Eksperti kontabël i autorizuar është përgjegjës ndaj shoqërisë dhe ndaj te tretëve për pasojat e dëmshme që rrjedhin nga fajet dhe nënvleftësimet në ushtrimin e funksionit të tij, por nuk është ligjërisht përgjegjës për shkeljet ligjor të kryera nga administratori me përjashtim të rasteve kur ka pasur dijeni për to, por nuk i ka zbuluar dhe raportuar ato asamblesë së ortakëve.

**Honorarët e ekspertit kontabël.**

Honorarët e ekspertit kontabël të autorizuar paguhen nga shoqëria.

**NENI 17**  
**DIVIDENTËT**

Pas plotësimit të parashikimeve të nenit 77 të Ligjit, shoqëria me shumicë të kualifikuar të votave së Asamblesë së Përgjithshme mund të deklarojë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me kuotat, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhen në përputhje me shumatat e paguara për kuotat për të cilët paguhet dividendi. Të gjithë dividendët pjesëtohen dhe paguhen në përpjesëtim të drejtë me shumatat e paguara për kuotat, pjesës ose pjesëve të periudhës për të cilën paguhet dividendi; në rast se kuota emetohet me kushtin e përfitimit të dividendit nga një datë e caktuar, dividendi do të paguhet në përputhje me këtë kusht.

Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një kuotë nuk do të mbartë interesa ndaj shoqërisë nëse nuk parashikohet nga të drejtat që lidhen me kuotën.

Çdo dividend që nuk është kërkuar të paguhet brenda dymbëdhjetë vjetëve nga data e maturimit, në rast se vendoset me shumicë të kualifikuar votash nga Asambleja e Përgjithshme, do të përfitohet nga shoqëria e cila nuk do të jetë më e detyruar që ta paguajë atë.

**NENI 18**  
**VITI FINANCIAR**

Çdo vit financiar fillor me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.

**NENI 19**  
**LIKUIDIMI**



Shoqëria është në likuidim e sipër që në momentin e prishjes së saj, operacion i cili do të kryhet sipas kërkesave të parashikuara në legjislacionin tregtar shqiptar.

***NENI 20***

**MOSMARRËVESHJET**

Mosmarrëveshjet zgjidhen me mirëkuptim.

Ne rast të kundërt, ortaket do të drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor ku Shoqëria ka selinë, për zgjidhje.

***NENI 21***

**DISPOZITA TË FUNDIT**

Për sa nuk është parashikuar në këtë statut, do të bëhet referim në dispozitat e legjislacionit tregtar dhe atij shqiptar në përgjithësi.

Nëse dispozitat e përmbajtura në Marrëveshjen e Shoqërisë janë në mospërputhje me Statutin e Shoqërisë, Statuti i Shoqërisë do të mbizotërojë.

Ky statut mund të përmirësohet dhe të ndryshohet me të njëjtën procedure që është lëshuar. Pronari do të bëjë përmirësimet dhe ndryshimet.

Statuti do të hyjë në fuqi me datën e themelimit të Shoqërisë.

***NENI 22***

Ky statut është hartuar në 3 (tre) origjinalë.

***ORTAKU I SHOQËRISË***

**“Grand Construction” SHPK**

**Z. Roland Hysa**

Roland Hysa

